Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Agnese Ibrahimi	**29.12.2023**	**12.01.2024**	**2023/1045**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 22.12.2023, OE "Botek shpk"- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/1045, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Aritech"- Lipjan, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizimi me paisje teknologjike (kompjutera, lloptopa, videoprojektora dhe paisje tjera)" me nr. të prokurimit: "624-23-13123-5-5-8", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA SUHAREKË.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të kufizuar, lloji i kontratës: furnizim.

Fazat e procedurës së prokurimit:

Ftesa për ofertim: 25/11/2023

Vendimi i AK-së: 08/12/2023

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë nuk është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/1045 i dt:22.12.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Përmes kësaj ankese, kundërshtojmë Vendimin e AK-Komuna e Suharekës. Në vazhdim po paraqesim përgjigjet e AK-së në pretendimet tona, dhe kundërshtimin (arsyetimin tonë) në këtë rast:

1.

Përgjigja nga AK: *Pretendimi i parë, mbi Deklaratën e specifikimeve teknike nuk qëndron sepse Deklarata mbi Specifikimet Teknike eshte bashkangjitur ne dokumentacionin e ofertes se ofruar nga OE fitues dhe si e till eshte valide dhe me specifikacione te detajuara .*

Kundërshtimi jonë: Kjo nuk qëndron, pasi që deklarata e specifikimeve teknike të cilën e ka dorëzuar OE i propozuar për kontratë, nuk është asgjë më shumë përvecse një deklarim me shkrim se ky OE i përmbush me ofertën e tij specifikimet teknike, sipas kërkesës së AK-së.

Sikurse e kemi parashtruar edhe në Kërkesën për Rishqyrtim, kjo deklaratë nuk përmbush kërkesat sipas FPO-së, Marrëveshjes publike kornizë (bazë për këtë procedurë të mini-tenderit), LPP-së dhe RrPP-së.

- Në Marrëveshjen Publike Kornizë (bazë për këtë Ftesë për Ofertim), shprehimisht kërkohet që: për secilin produkt duhet të specifikoni emrin e modelit që ofertoni. Në kolonën e parë të secilit produkt tek – Prodhuesi – Brand Name, duhet të shkruani emrin e modelit duke përfshirë emrin e prodhuesit dhe emrin e saktë të modelit të cilin e ofroni.

- Sipas **Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik,** pika 10 – Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve – *Nëse Mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu ("specifikimit teknik" – AK përcakton kërkesat minimale dhe maksimale të një produkti, ndërsa OE duhet të dorëzoj specifikimin e detajuar të mallrave të ofruara. Përveç ne raste kur OE nuk mund të dorëzoj specifikimin teknik të një produkti të caktuar p.sh. peme/ përime etj.* Pra, nëse OE dorëzon deklaratën ku deklaron se mallrat do të jenë në përputhje me specifikimin e kërkuar), atëherë AK duhet të veproj duke **Refuzuar tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm**, bazuar në nenin 28 të LPP. Pra, sipas udhëzuesit, OE gjithmonë duhet të dorëzojnë specifikimin e detajuar të pajisjeve të ofruara në rastin e procedurave që kanë objekt të kontratës pajisje sikur edhe kjo procedurë, pasi që për pajisje të TI mund të ofrohet gjithmonë specifikim i detajuar teknik.

Prova 1_ **Udhëzuesi Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik,** pika 10

Prandaj, siç shihet më sipër bazuar në LPP dhe të gjitha dispozitat ligjore në fuqi, ky OE duhet të shpallet i papërgjegjshëm.

2.

Përgjigja nga AK: *Pretendimi 2, për Broshurat, nuk qëndron sepse edhe te kjo pike janë te ofruara specifikacionet mbi produktet e teknologjise dhe ate ne detaje qe po ashtu po ua ofrojme te bashkangjitur.*

Kundërshtimi jonë: Sipas **Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik,** pika 10 – Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve - Është dorëzuar katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara- Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm (sipas nenit 69 të LPP-së).

Në vendimin e tyre AK-Komuna e Suharekës tenton të shtrëmbëroj faktet, duke paraqitur si provë një broshurë të OE të propozuar për kontratë, respektivisht broshurën për artikullin monitor. Në këtë aktivitet prokurimi nuk janë kërkuar vetëm monitora, të cilët në broshurën e tyre kanë vetëm një opsion për një specifikë të mundshme por edhe PC e Laptop, për të cilët duhet të definohet se cilat opsione nga specifikimet ofertohen. E pikërisht këtë ne e kemi shprehur edhe në Kërkesën tonë për Rishqyrtim, ku kemi thënë, citat: OE Aritech shpk ka dorëzuar broshurat e produkteve të ofertuara, por, në broshura ekzistojnë disa opsione të ndryshme për të njëjtin specifikim, si psh. për procesor, memorie, storage, kartelë grafike etj dhe ky OE nuk ka nënvizuar opsionet me të cilat oferton dhe të cilat përmbushin kërkesat në Aneksin 1 – Specifikimet teknike të detyrueshme. Mirëpo, pavarësisht kësaj, siç shihet edhe nga LPP, edhe nëse OE në fjalë do kishte nënvizuar broshurat, përsëri sipas LPP, RrPP dhe Udhëzuesit, ai do duhej të eliminohej, por këtë po e sqarojmë si fakt shtesë për të vërtetuar përtej çdo dyshimi se vendimi i AK ndaj KpR tonë është jo i drejtë.

Vazhdimi i përgjigjes së AK-së, pretendimi 2. *Ndërsa sa i përket pretendimit për OE të dytë edhe ketu nuk keni të drejtë sepse* ***Deklarata mbi Përshtatshmërinë dhe Afati i Liferimit*** *janë të specicikuara dhe të detajuara dhe po ua forojmë më poshtë si të tilla:*

Kundërshtimi jonë: Në këtë rast kemi të bëjmë me dokumentet e dorëzuara nga OE i dytë për nga çmimi, Tech Vision shpk, i cili poashtu nuk ka dorëzuar një specifikim teknik të detajuar të produkteve që oferton, por vetëm ka dorëzuar dokumentin **Deklaratë mbi Përshtatshmërinë dhe Afati i Liferimit** përmes të cilit ka deklaruar thjesht se (cit) : *specifikimet teknike të ofruara nga ana jonë, përputhen me ato të ANEKSIT 1 të FPO'së...*

Prova 2_Deklaratat e dorëzuara nga OE Aritech shpk dhe OE Tech Vision shpk

Edhe kjo, sikurse tek OE i propozuar për kontratë Aritech shpk, nuk mjafton për të paraqitur produktet e ofruara. Pra, është më se e qartë se OE i propozuar për kontratë dhe OE i dytë për nga çmimi, nuk janë të përgjegjshëm administrativisht.

Rrjedhimisht dhe AK-Komuna e Suharekës ka bërë shkelje të LPP-së, më saktësisht të Nenit 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, duke mos marrë për bazë LPP-në, gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, pasi që në një situatë të tillë, AK do të duhej të eliminonte si të papërgjegjshëm këta OE.

Kundërshtimet tona vërtetohen edhe më tej nga vendimi i PSH të OSHP-së në ankesën tonë nr. 214/22, e cila ka trajtuar lëshimet e njëjta në procedurat e llojit të njëjtë si kjo nga AK-Komuna Suharekë.

Prova 3 Vendimi i OSHP nr. 214/22

KRITERET PËR VLERËSIM

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINA SUVA REKA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA

Nr: 97/2023	**Nr: Protokolli: 147/2023**
Për:	**Operatorin Ekonomik: " Botek shpk, Rr. Agim Ramadani, Objekti C, Prishtine, 10000, Kosove**
Nga:	Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit: **Fatos Kuqi**
Lënda:	**VENDIM** për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	**15.12.2023**

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës në mbështetje të nenit 108/A paragrafi 10.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores **Nr. 001/2022** për Prokurim Publik , sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim**, të parashtruar me datë: **13.12.2023** nga Operatori Ekonomik: **:** " **Botek shpk, Rr. Agim Ramadani, Objekti C, Prishtine, 10000, Kosove** me adresë në **Prishtinë** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizimi me paisje teknologjike (kompjutera, lloptopa, videoprojektora dhe paisje tjera)** me me Numër të prokurimit: **624-23-13123-5-5-8** Numër i brendshëm: **624-23-70-558** nxjerr këtë:

VENDIM

I. **REFUZOHET** Kërkesa për Rishqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Botek shpk, Rr. Agim Ramadani, Objekti C, Prishtine, 10000, Kosove** me adresë në **Prishtinë** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizimi me paisje teknologjike (kompjutera, lloptopa, videoprojektora dhe paisje tjera)** me Numër të prokurimit: **624-23-13123-5-5-8** Numër i brendshëm: : **624-23-70-558** kundër: (NJOFTIM VENDIMIT TE AK) , të datës: **08.12.2023** të publikuar në ueb–faqe: https://e-prokurimi.rks-gov.net

II. Autoriteti Kontraktues vendos të **REFUZOHET** Kërkesa për Rishqyrtim për aktivitetin e prokurimit: **Furnizimi me paisje teknologjike (kompjutera, lloptopa, videoprojektora dhe paisje tjera)** me Numër të prokurimit: **624-23-13123-5-5-8** Numër i brendshëm: **624-23-70-558**

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: https://e-prokurimi.rks-gov.net

A R S Y E T I M

Operatori Ekonomik: **Botek shpk, Rr. Agim Ramadani, Objekti C, Prishtine, 10000, Kosove** me adresë në **Pritshtinë** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizimi me paisje teknologjike (kompjutera, lloptopa, videoprojektora dhe paisje tjera)** me Numër të prokurimit: **624-23-13123-5-5-8** Numër i brendshëm : **624-23-70-558**

Kundër (NJOFTIM VENDIMIT TE AK) , të datës: **08.12.2023** të publikuar në ueb–faqe: https://e-prokurimi.rks-gov.net, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **13.12.2023** sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Autoriteti Kontraktues **Refuzon** kërkesën tuaj për **Rishqyrtim** pasi që konsiderohet si e pa bazuar sepse në pretendimet tuaja për mungesë të **Specifikacioneve tekinike** dhe **Deklaratave** të OE fitues të përgjegjshëm, mbi produktet e ofruara, nuk qëndrojnë sepse si të tilla po u'a dërgojmë përmes kësaj shkrese dhe se kërkesa juaja për t'a kthyer lëndën në Rivlerësi, refuzohet si e bazuar në argumentet që Komisioni Vlerësues ka bërë vlerësim real dhe të drejtë duke e mbrojtur paranë publike dhe duke e respektuar ligjin e **Prokurimit Publik** në përpikmëri, e po ashtu Zyra e Prokurimit e ka analizuar me kujdes kërkesën tuaj dhe në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin Vlerësues, kanë nxjerrë këtë vendim për refuzim.

Pretendimi 1, mbi Deklaraten e specifikimeve teknike, nuk qendron sepse Deklarata mbi Specifikim Teknik eshte e bashkangjitur ne dokumentacionin e ofertes se ofruar nga OE fitues dhe si e till eshte valide dhe me specifikacione te detajuara:

Pretendimi 2, për Broshurat, nuk qendron sepse edhe te kjo pike jane te ofruara specifikacionet mbi produktet e teknologjise dhe ate ne detaje qe po ashtu po ua ofrojme te bashkangjitur:

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

n/a

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

n/a

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

n/a

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Botek shpk**

Sqarimi hyrës: Pretendimet të cilat janë ngritur nga OE ankues, janë shqyrtuar nga eksperti shqyrtues dhe i njëjti ka dhënë përgjigje si më poshtë.

Pretendimi 1

OE ankues pretendon që: *"Deklarata e specifikimeve teknike të cilën e ka dorëzuar OE i propozuar për kontratë, nuk është asgjë më shumë përveçse një deklarim me shkrim se ky OE i përmbush me ofertën e tij specifikimet teknike sipas kërkesës së AK-së. Kjo deklaratë nuk përmbush kërkesat sipas FPO-së, Marrëveshjes publike kornizë (bazë për këtë procedurë të mini-tenderit), LPP-së dhe RRPP-së. Në Marrëveshjen Publike Kornizë (bazë për këtë Ftesë për Ofertim), shprehimisht kërkohet që për secilin produkt duhet të specifikoni emrin e modelit që ofertoni. Në kolonën e parë të secilit produkt tek-Prodhuesi-Brand Name, duhet të shkruani emrin e modelit duke përfshirë emrin e prodhuesit dhe emrin e saktë të modelit të cilin e ofroni. Sipas Udhëzuesit, pika 10, AK duhet të veproj duke Refuzuar tenderin pa kërkuar informacione të mëtejshme, bazuar në neni 28 të LPP-së.*

Në vendimin e tyre, AK tenton të shtrembëroj faktet, duke paraqitur si provë një broshurë të OE të propozuar për kontratë, respektivisht broshurën për artikullin monitor. Në këtë aktivitet nuk janë kërkuar vetëm monitora por edhe PC dhe Laptop, për të cilat duhet të definohen se cilat opsione nga specifikimet ofertohen. Edhe nëse OE i rekomanduar do të kishte nënvizuar opsionet me të cilat oferton dhe të cilat përmbushin kërkesat në Aneksi 1- Specifikimet teknike të detyrueshme, përsëri sipas LPP, RRPP dhe Udhëzuesit ai do të duhej të eleminohej."

Eksperti shqyrtues përmes e-mailit zyrtar ka kërkuar nga AK që të dërgoj Ftesën për Ofertim e cila i është dërguar edhe operatorëve pjesëmarrës. Pjesë e kësaj ftese për ofertim ka qenë edhe Ankesi 1-Specifikimet teknike të detyrueshme. Eksperti sqaron se OE i rekomanduar, nuk ka

dorëzuar fare Aneksin 1 sipas FPO-së, por ai ka dorëzuar në ofertë vetëm disa broshura për produktete e kërkuara sipas Aneksi 1. Edhe pse në këto broshura janë produktet të cilat përmbajnë edhe specifikat e tyre teknike dhe të dhëna të tjera për pajisjet si çdo katalog apo broshurë tjetër, megjithatë mosplotësimi dhe mosdorëzimi me ofertë i Ankesi 1 përkatësisht specifikave teknike sipas FPO-së dhe Marrëveshjes Publike Kornizë, përbënë mosplotësim të kritereve të kërkuara. Duke qenë se kërkesë e FPO-së nuk ka qenë që operatorët ofertues të dorëzojnë katalogun/broshurën, por vetëm specifikat teknike sipas Aneksi 1 të FPO-së, atëherë eksperti mendon se OE i rekomanduar nuk mund të eleminohet sipas pikës 10 të Udhëzuesit për Prokurim Publik, kur një kërkesë e tillë për katalog nuk është bërë nga ana e AK-së. Megjithatë, mosdorëzimi i Ankesi 1 me specifika teknike konsiderojmë që tregon një papërgjegjshmëri të OE i rekomanduar.

Gjithashtu eksperti pasqyron se në ofertë OE i rekomanduar ka dorëzuar edhe një deklaratë (dokumenti 4 i ofertës) me të cilën operatori pranon se i përmbushë specifikat teknike sipas kërkesës, mirëpo në këtë deklaratë nuk është cekur asnjë e dhënë e produkteve përfshirë prodhuesin apo produktet e ofertuara. Gjithashtu vlenë të theksohet se rast i ngjashëm është shqyrtuar edhe më parë nga paneli shqyrtues përkatësisht me- Vendimi i OSHP-së me numër 214/22. Vlerësojmë që ky pretendim i ngritur është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi 2

"Dokumentet e dorëzuara nga OE i dytë për nga çmimi, i cili po ashtu nuk ka dorëzuar një specifikim teknik të detajuar të produkteve që oferton, por vetëm ka dorëzuar dokumentin Deklaratë mbi Përshtatshmërinë dhe Afati i Liferimit përmes të cilit ka deklaruar thjeshtë se specifikimet teknike të ofruara nga ana jonë, përputhen me ato të Ankesit 1 të FPO-së. Edhe kjo, sikurse tek OE i propozuar për kontratë, nuk mjafton për të paraqitur produktet e ofruara."

Sa i përket këtij pretendimi edhe eksperti shqyrtues mendon se OE i rënditur si i dyti për nga çmimi, nuk ka plotësuar specifikacionet teknike sipas Aneksi 1 të FPO-së. Një nga të dhënat të cilat nuk janë plotësuar fare nga ana e këtij operatori është pikërisht emri i brendit të produktit me të cilin oferton operatori dhe që është informacion mjaft i rëndësishëm në këtë lloj procedure. Në ofertën e këtij operatori ekonomik në asnjë pjesë të saj nuk ceket emri i brendit të produkteve me të cilat oferton. Edhe në deklaratën mbi përshtatshmërinë (pika 3 e ofertës) e dorëzuar me ofertë ku cekë se produktet janë në përputhje me specifikat teknike të kërkuara, prapë as ky dokument nuk përmbanë asnjë të dhënë sa i përket prodhuesit apo produkteve. Në të gjitha pjesët ku është kërkuar të plotësohet "Brand Name", asnjëra pjesë e kësaj kërkese nuk është plotësuar, sipas Marrëveshjes Kornizë, për çdo produkt të ofertuar duhet specifikuar emri i modelit, përfshirë emrin e prodhuesit dhe emrin e saktë të modelit, gjë që ky operator nuk e ka specifikuar në asnjë pjesë të ofertës. Andaj, eksperti vlerëson se as operatori i dytë nuk e ka plotësuar Ankeksi 1 sipas kërkesave dhe konsideron që ky pretendim është i bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA SUHAREKË**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Botek shpk**

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA

Agnese Ibrahimi

Ibrahimi